



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.51/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Lazić dhe Adnan Konushevc i anëtar, me zyrtarin ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje(LVV) dega në Pejë, për shkak të vendosjes së posterit në hapësirat publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2017, mori këtë:

#### **V E N D I M**

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), kështu që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje(LVV), i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 1,500,00 (një mijë e pesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**

#### **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 05.06.2017, nga Instituti Demokratik i Kosovës(KDI) me të cilën pretendon se me datën 04.06.2017, ka vërejtur se në rrugën kryesore të qytetit Mbretëresha Teuta në Pejë në të dy anët e rrugës, monitoruesi e ynë ka hasur në postierin e kandidatit për deputet të kuvendit nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje për një tubim elektorale të vendosur në hapësirat publike gjegjësisht në drunjtë të qytetit. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 paragrafi 1,pika b),të LPZ-së duke pretenduar se subjekti në fjalë ka shkel këto nene në momentin që ka vendosur posterin në hapësirë publike. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur 1(një)fotografim të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 06.06.2017,subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, thekson se materiali ka qen për informimin e qytetarëve për të marrë pjesë në sheshin kryesor të qytetit të Pejës për të cilin aktivitet politik ishte i informuar edhe KQZ-ja në Pejë. Andaj Lëvizja Vetëvendosje ka ndërmarrë masa për të evituar shkeljet e mundshme nga anëtarët, mbështetësit apo kandidatët për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Këtë e vertetojmë se Lëvizja Vetëvendosje ka dekurajuar të gjithë personat për të ndërmarrë veprimet që janë në kundërshtim me Kodin dhe për këtë konsideroi se PZAP-i, do të duhet të përjashtonte përgjegjësin e Lëvizjes Vetëvendosje , për këtë veprim gjatë shqyrtimit të ankesës në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

## **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se postieri i kandidatit për deputet në fushatën zgjedhore i subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, është vendosur në hapësirat publike e cilat shfrytëzohen për shërbime publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.
- Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase koalicioni PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti se posteri i kandidatit për deputet është vendosur në hapësira publik.

Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ia dha mundësin për tu përgjigjur ashtu që në përgjigje e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarr veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartasin e gjobës së shqiptuar si në dispozitivin të këtij vendimi.

Nga të dhënat e cekura si më lart Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 51/2017 më datën 06.06.2017.

**Kryesuesi i Panelit  
Fejzullah Rexhepi**



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së: